Funded
by the European Union
and the Council of Europe

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë[1] (PECK)
www.coe.int/peck

Raporti përmbyllës narrativ

Titulli i projektit	Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë (PECK)
Numri i referencës	IPA 2011 – CRIS Nr. 2011/282-152
Data e fillimit të projektit	1 shkurt 2012
Kohëzgjatja e projektit	1 shkurt 2012 - 30 qershor 2015 (41 muaj)
Zbatimi	Njësia për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik, Departamenti për Veprimin kundër Krimit - DGI, Këshilli i Evropës
Buxheti i projektit	1.200.000 € (BE 83,3% dhe KiE 16,7%)
Periudha raportuese	1 shkurt 2012 - 30 qershor 2015
Data e raportit	21 dhjetor 2015

[1] Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Për më shumë informacion ju lutemi të kontaktoni: Njësinë për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik (ECCU) Departamentin për Veprimin kundër Krimit Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, Këshilli i Evropës F- 67075 Strasbourg ✉maia.mamulashvili@coe.int ☎ + 33 3 90 21 42 14 www.coe.int/corruption	Ky dokument është realizuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Qëndrimet e shprehura në të nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë pozitën zyrtare të Bashkimit Evropian dhe/ose të Këshillit të Evropës .

Përmbajtja

1 PËRSHKRIMI 4

1.1 PERSONI KONTAKTUES 4
1.2 EMRAT E PARTNERËVE NË VEPRIM 4
1.3 TITULLI I VEPRIMIT: 4
1.4 NUMRI I KONTRATËS 4
1.5 DATA E FILLIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË PERIUDHËS RAPORTUESE 4
1.6 RAJONI I SYNUAR 4
1.7 INSTITUCIONET PËRFITUESE 4
1.8 AUTORITETI KONTRAKTUES 5
1.9 ORGANIZATA ZBATUESE 5

2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 6

3 PËRSHKRIMI I VEPRIMIT 8

3.1 OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 8
3.2 QËLLIMI I PROJEKTIT 8
3.3 REZULTATET E PRITSHME (RP) 8
3.4 PLANI I PUNËS/NDRYSHIME TË TJERA 9
3.5 VËSHTIRËSITË E HASURA GJATË ZBATIMIT 10

4 VLERËSIMI I REZULTATEVE DHE ARRITJEVE TË PROJEKTIT 11

4.1 ARRITJET SIPAS REZULTATEVE TË PRITSHME (RP) 11
4.2 QËLLIMI I PROJEKTIT: VLERËSIMI I ZBATIMIT 14
4.3 VLERËSIMI I PRODUKTEVE TË DORËZUARA TË PROJEKTIT 16

5 BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESUARA 29

5.1 PËRFITUESIT HOMOLOGË 29
5.2 PALËT E TJERA TË TRETA 29

6 MONITORIMI DHE VLERËSIMI 31

7 PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET 33

7.1 PËRFUNDIMET DHE MËSIMET E NXJERRA 33
7.2 REKOMANDIMET 34

8 LISTA E SHTOJCAVE 36

8.1 SHTOJCA I: AKTIVITETE PROMOVIMI 37
8.2 SHTOJCA II: PLANI I RISHIKUAR I PUNËS 43
8.3 SHTOJCA III: LISTA E DOKUMENTEVE TEKNIKE/PRODUKTEVE TË PROJEKTIT PECK 46

1 PËRSHKRIMI

1.1 Personi kontaktues

Ardita Abdiu
Shef i Njësisë për Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik
Departamenti për Veprimin kundër Krimit
Drejtoria e Shoqërisë së Informacionit dhe Veprimit kundër Krimit
Drejtoria e Përgjithshme I - për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit

1.2 Emrat e Partnerëve në Veprim

Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian.

1.3 Titulli i veprimit:

Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë (PECK)

1.4 Numri i kontratës

IPA 2011 – CRIS Nr. 2011/282-152

1.5 Data e fillimit dhe përfundimit të periudhës raportuese

1 shkurt 2012 - 30 qershor 2015

1.6 Rajoni i synuar

Kosovë

1.7 Institucionet përfituese

Institucionet përfituese kryesore: Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (AKK), Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF), Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (ZQM) në zyrën e Kryeministrit.

Përfituesit e projektit përfshijnë (pa kufizim) agjencitë kyçe në vijim, të cilat luajnë rol në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit në Kosovë:

- Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK)
- Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Krimit Ekonomik (KKLKE)
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)
- Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)
- Policia e Kosovës (PK)
- Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)
- Ministria e Drejtësisë (MD)
- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)
- Ministria e Financave (MF)
- Ministria e Administratës Publike (MAP)
- Banka Qendrore e Kosovës (BQK)
- Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI)
- Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK)

- Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të (DRNOJQ)
- Doganat e Kosovës (DK)
- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)
- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP)
- Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP)
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP)
- Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP)
- Kuvendi i Kosovës (KK)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)
- Avokati i Popullit i Kosovës (KO)
- Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK)

1.8 Autoriteti kontraktues

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE)

1.9 Organizata zbatuese

Këshilli i Evropës ishte përgjegjës për zbatimin e projektit dhe përdorimin e fondeve të projektit në kuadër të Marrëveshjes mes Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në Strasburg, Drejtorisë së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, dhe më konkretisht, në kuadër të Departamentit të Veprimit kundër Krimit, Njësia pë Bashkëpunimin kundër Krimit Ekonomik ishte përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm dhe mbikëqyrjen e Projektit me Ekipin e projektit të vendosur në Prishtinë që ka qenë përgjegjës për mbarëvajtjen e përditshme të projektit.

2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Objektivi kryesor i projektit ishte që të kontribuojë për demokracinë dhe shtetin e së drejtës nëpërmjet parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë.

Korrupsioni, pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit mbeten sfida serioze për Kosovën. Parandalimi dhe lufta efikase kundër këtyre fenomeneve ka qenë prioritet në agjendën e reformave të autoriteteve të Kosovës në vitet e fundit, veçanërisht nën dritën e procesit të integrimit evropian. Edhe pse janë ndërmarrë një sërë reformash, nuk ishte kryer ndonjëherë asnjë proces gjithëpërfshirës, i strukturuar dhe më afatgjatë për të vlerësuar përparimin dhe ndikimin e tyre. Projekti PECK u projektua për të adresuar këtë boshllëk, duke kryer një vlerësim të parë të plotë të pajtueshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare të luftës kundër korrupsionit (LKK), kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit (LPP/LFT). Vlerësimi u mbështet në metodologjitë e përdorura nga GRECO dhe FATF/MONEYAL dhe u përshtat në mënyrë specifike për Kosovën. Ai u krye në dy cikle, duke mbuluar fushat institucionale, ligjore, të politikave dhe operative të ndara në tema të veçanta.

Cikli i parë i vlerësimit (2012/2013) shqyrtoi efektivitetin e kornizave institucionale dhe rregullatore dhe përputhshmërinë e tyre me standardet e zbatueshme ndërkombëtare, si dhe identifikoi mangësitë dhe rreziqet. Cikli i dytë (2013/2014) u përqendrua në sigurimin e zbatimit të qëndrueshëm nga ana e autoriteteve përmes veprimeve pasuese dhe në vlerësimin e një game të gjerë të standardeve ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e LPP/LFT. Një vlerësim në mes të procesit u krye me qëllim që të përcaktohej progresi i arritur në zbatimin e rekomandimeve të dhëna gjatë ciklit të parë.

Produktet kryesore të projektit janë **raporte vlerësimi** gjithëpërfshirëse në anglisht, shqip dhe serbisht që përmbajnë një analizë të thellë të kornizave të Kosovës në LKK dhe LPP/LFT, si dhe rekomandime specifike për reformat e nevojshme legjislative, institucionale dhe të politikave në fushën e krimit ekonomik. Këto raporte shërbejnë si **bazë** për autoritetet lokale dhe të gjithë aktorët e tjerë që punojnë për të përmirësuar situatën me krimin ekonomik në Kosovë, dhe formojnë një bazë solide për riorganizimin e asistencës teknike ndërkombëtare për Kosovën.

Gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimit të Projektit PECK janë kthyer në pikë referimi për raportet e institucioneve të shumta vendore dhe organizatave ndërkombëtare (FMN, UNDP, etj.). Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës përdori raportin e vlerësimit për LPP/LFT në mbështetje të kërkesës së saj për anëtarësim në **Egmont Group.** Gjithashtu, projekti pati **ndikim të drejtpërdrejtë,** megjithëse të kufizuar deri tani, në disa politika dhe nisma reformuese legjislative: ndryshimet e Ligjit për financimin e subjekteve politike, nisjen e vlerësimit të rrezikut kombëtar të LPP/LFT dhe rishikimin e ligjit për LPP/LFT. Një numër i nismave legjislative të frymëzuara nga rekomandimet e PECK janë finalizuar, ose janë aktualisht në shqyrtim parlamentar (p.sh. paketa e reformës në drejtësi). Në konferencën përmbyllëse të Projektit, autoritetet e Kosovës përsëritën angazhimin e tyre të vendosur për zbatimin e rekomandimeve të mbetura. NJIF-K ka hartuar një plan të veçantë të veprimit për adresimin e rekomandimeve të vlerësimit në fushën e LPP/LFT. Një ndikim më i

konsiderueshëm pritet të ndodhë pasi të jenë adresuar edhe rekomandimet e mbetura, duke përmirësuar në mënyrë domethënëse përputhshmërinë me standardet përkatëse ndërkombëtare.

Nëpërmjet procesit të vlerësimit rigoroz, plotësuar me ndërhyrjet e tjera të ndryshme (seminare mbi metodologjitë e vlerësimit dhe praktikat më të mira, përfshirë statistikat, konferencat ndërkombëtare për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushat e LKK dhe LPP/LFT, vizita studimore, etj.), projekti mbuloi më shumë se 30 institucione përfituese (përfshirë ministritë kryesore, institucionet qendrore dhe agjencitë ekzekutive, organet e zbatimit të ligjit, gjyqësorin dhe sektorin financiar) duke kontribuar në zhvillimin dhe/ose **rritjen e kapaciteteve të tyre institucionale në** fushat e LKK dhe LPP/LFT.

Në tërësi, projekti zbatoi **43 aktivitete/veprime** gjatë periudhës prej 41 muajsh dhe ka përfituar nga dy zgjatje pa kosto për të konsoliduar rezultatet e arritura, për t'u dhënë autoriteteve më shumë kohë për të zbatuar rekomandimet e vlerësimit dhe për t'iu përgjigjur nevojave të tyre në zhvillim. Gjithsej **935 pjesëmarrës** kanë marrë pjesë në aktivitetet e projektit, nga të cilët **25%** ishin **gra**. Mbi **50 pika kontakti** nga institucionet përfituese janë trajnuar për të menaxhuar dhe ndjekur ushtrimet ndërkombëtare të vlerësimit.

Projekti vendosi bashkëpunim shumë të mirë me institucionet kryesore përfituese, dhe në veçanti me dy institucionet kryesore koordinuese - Agjencinë Kosovare kundër Korrupsionit (AKK) dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare (NJIF) - të cilat në mënyrë aktive morën pjesë dhe mbështetën aktivitetet e projektit. Sigurimi i pronësisë vendore ka qenë një parim udhëheqës për të gjitha ndërhyrjet e projektit.

Projekti PECK ka arritur rezultatet e pritshme dhe përfundoi me sukses fazën e shtyrjes së tij në qershor 2015. Vlera e rezultateve të projektit është pranuar nga vlerësimi i fundit i mbështetjes IPA për luftën kundër korrupsionit, i porositur nga BE-ja, i cili thotë se "Projekti PECK ka qenë **instrumental** në vlerësimin e statusit të Kosovës në lidhje me standardet e GRECO-s dhe të FATF-it [...] dhe ka dorëzuar **produkte me cilësi shumë të mira** dhe është vlerësuar lart nga përfituesi". Duke pasur parasysh suksesin dhe rëndësinë e vazhdimit me procesin e strukturuar dhe gjithëpërfshirës të vlerësimit të Kosovës, veçanërisht nën dritën e standardeve ndërkombëtare në zhvillim, është hartuar një projekt vazhdues (PECK II), i cili është në pritje të nënshkrimit. PECK II do të mbështetet në rezultatet dhe mësimet e nxjerra nga Projekti aktual dhe përveç vazhdimit të vlerësimit do të ndihmojë autoritetet e Kosovës me zbatimin e rekomandimeve specifike nëpërmjet asistencës teknike të shënjestruar.

3 PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK) është financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, dhe është zbatuar nga Këshilli i Evropës. Kohëzgjatja fillestare e projektit ishte 30 muaj (1 shkurt 2012 - 31 korrik 2014). Projekti u zgjat dy herë pa kosto: zgjatja e parë (1 gusht 2014 - 31 mars 2015) u miratua në korrik të vitit 2014, dhe e dyta (1 prill - 30 qershor 2015) në mars 2015. Buxheti i përgjithshëm i projektit ishte 1.2 milion € (kontributi i BE 1.0 milion €; KiE – € 200,000).

Projekti rrjedh nga nevoja e Kosovës për një proces gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të vlerësimit. Edhe pse reformat kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave kanë qenë në proces për disa vite, nuk ishte kryer ndonjëherë asnjë proces i strukturuar dhe më afatgjatë për të vlerësuar progresin dhe ndikimin e tyre. Projekti PECK u hartua për të trajtuar këtë boshllëk dhe kreu për herë të parë në llojin e vet vlerësimin e përputhshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare të LKK dhe LPP/LFT, i modeluar sipas vlerësimeve të GRECO-s dhe MONEYVAL dhe i përshtatur në mënyrë specifike për Kosovën. Qëllimi ishte që të lejohej Kosova, që nuk është pjesë e kornizës së konventave dhe mekanizmave të Këshillit të Evropës për të përfituar nga standardet e KiE për sundimin e ligjit, si dhe për të sjellë dhe ndarë përvojën e procedurave të monitorimit të cilave u nënshtrohen shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Ndërhyrjet e projektit u hartuan në mënyrë të tillë që të përfshihen në mënyrë aktive institucionet përfituese të Kosovës në të gjitha fazat, duke ndërtuar dhe/ose forcuar kapacitetet e tyre për të mbështetur dhe për të kryer vlerësime kolegjiale në mbështetje të metodologjive të organeve evropiane. Kjo ishte edhe nisma e parë për Këshillin e Evropës për të kryer njëkohësisht vlerësimin e përbashkët të kornizave të LKK dhe LPP/LFT, duke mbuluar të katër raundet e vlerësimit të GRECO-s dhe MONEYVAL-it, të cilat shtetet anëtare normalisht i ndërmorën në faza, përgjatë rreth 15 viteve.

3.1 Objektivi i përgjithshëm

Të kontribuojë për demokracinë dhe shtetin e së drejtës nëpërmjet parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë.

3.2 Qëllimi i projektit

Të forcohen kapacitetet institucionale për të luftuar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë në përputhje me standardet evropiane përmes vlerësimeve të plota dhe rekomandimeve për përmirësimin dhe riorganizimin e reformave kundër krimit ekonomik.

3.3 Rezultatet e pritshme (RP)

Rezultati i pritshëm 1 - Vlerësimi i masave kundër korrupsionit:

RP 1.1 Raportet e vlerësimit dhe progresit janë në dispozicion për nivelin e pajtueshmërisë së rregulloreve dhe praktikave në fuqi me standardet evropiane (bazuar në përvojën dhe kriteret e përdorura nga GRECO dhe organet e tjera përkatëse ndërkombëtare);

RP 1.2 Institucionet e Kosovës janë të afta të mbështesin dhe të kryejnë vlerësime kolegjiale për masat kundër korrupsionit në bazë të metodologjisë evropiane të vlerësimit;

RP 1.3 Rekomandimet janë në dispozicion për fushat rregullatore, institucionale dhe të politikave të lidhura;

RP 1.4 Vlerësimi dhe raportet e progresit (përfshirë matricën e pajtueshmërisë) janë publikuar dhe shpërndarë në anglisht, shqip dhe serbisht.

Rezultati i pritshëm 2 - Vlerësimi i masave kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit:

RP 2.1 Raportet e vlerësimit dhe progresit janë në dispozicion për nivelin e pajtueshmërisë së rregulloreve dhe praktikave në fuqi me standardet evropiane (bazuar në përvojën dhe kriteret e përdorura nga MONEYVAL dhe organet e tjera përkatëse ndërkombëtare);

RP 2.2 Institucionet e Kosovës janë të afta të mbështesin dhe kryejnë vlerësime kolegjiale për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në bazë të metodologjisë evropiane dhe të mekanizmave të tjera ndërkombëtarë të vlerësimit;

RP 2.3 Rekomandimet janë në dispozicion për fushat rregullatore, institucionale dhe të politikave të lidhura;

RP 2.4 Vlerësimi dhe raportet e progresit (përfshirë matricën e pajtueshmërisë) janë publikuar dhe shpërndarë në anglisht, shqip dhe serbisht.

3.4 Plani i punës/ndryshime të tjera

Plani i punës së projektit u hartua gjatë fazës fillestare në konsultim të ngushtë me të gjithë përfituesit e përfshirë. Ai u rishikua lehtësisht disa herë për t'u përshtatur me nevojat në zhvillim të institucioneve përfituese dhe për të shmangur mbivendosje me organizata të tjera ndërkombëtare aktive në fushën e krimit ekonomik. Për dijeni, u hoq vizita studimore e planifikuar për komponentin e LPP/LFT (aktiviteti 1.15) për të shmangur dyfishimin me një tjetër projekt të financuar nga BE-ja, i cili parashihte dy vizita studimore për NJIF-in.

Plani i punës u rishikua për periudhën e zgjatjes pa kosto të projektit (1 gusht 2014 - 31 mars 2015), me qëllim për të kryer ciklin e 2^{të} të vlerësimit në mënyrë më efikase dhe për t'u lejuar autoriteteve të Kosovës më shumë kohë për të demonstruar përparim, konsoliduar rezultatet e arritura dhe për të përfituar plotësisht nga procesi i vlerësimit. Aktiviteti shtesë - mbështetje për rishikimin e ligjit për LPP/LFT - u shtua në planin e punës me miratimin e Komitetit Drejtues të Projektit në muajin prill 2014. Qëllimi ishte që të ndihmohej dhe mbështetej procesi i rishikimit të Ligjit për LPP/LFT bazuar në rekomandimet e vlerësimit të projektit PECK, si dhe në praktikat më të mira krahasuese dhe standardet përkatëse.

Projekti u zgjat pa kosto për herë të dytë (1 prill - 30 qershor 2015), në mënyrë që të zbuten vonesat e shkaktuara nga ngërçi politik 6-mujor pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2014 dhe për të zbatuar plotësisht të gjitha aktivitetet e parapara për rishikimin e Ligjit për LPP/LFT. Përveç shmangieve të vogla të lartpërmendura nga plani i punës, projekti i realizoi të gjitha aktivitetet e planifikuara.

Përveç aktiviteteve të planifikuara, në shtator të vitit 2012 projekti ofroi ekspertizë ligjore për ndryshimet e Ligjit për LPP/LFT me kërkesë të Ministrit të Financave të Kosovës dhe në marrëveshje me Zyrën e BE-së në Kosovë. Ky aktivitet ishte jashtë planit të punës së projektit PECK por kontribuoi dhe lehtësoi vlerësimin e PECK të kornizës për LPP/LFT.

3.5 Vështirësitë e hasura gjatë zbatimit

Projekti ka hasur disa vështirësi gjatë periudhës së zbatimit. Për dijeni, cikli i parë i vlerësimit filloi më vonë nga sa ishte parashikuar fillimisht për shkak të negociatave midis KE-së dhe BE-së (qershor-gusht 2012) për emërtimin e Kosovës që do të përdorej në fusnotë në dokumentet e lidhura me projektin. Kjo rezultoi në shkurtimin e kohës për zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit, pas miratimit zyrtar të raporteve të vlerësimit (qershor 2013). Kjo vështirësi u adresua nga zgjatja 8-mujore pa kosto e projektit, që u bë e mundur falë menaxhimit të shëndoshë dhe me kosto efektive të fondeve të projektit.

Disa vështirësi janë hasur në mbledhjen e informacionit dhe komenteve nga autoritetet përkatëse për raportet përcjellëse (të progresit), si dhe për përgjigjet ndaj Pyetësorit të ciklit të 2^{të} për LPP/LFT. Projekti i shtoi përpjekjet për të përfshirë aktivisht dhe për të marrë të dhëna nga të gjitha institucionet përfituese dhe përdori mënyra alternative të mbledhjes së informacionit, të plotësuara me udhëzime të vazhdueshme dhe mbështetjen e dhënë nga ekipi i projektit gjatë tërë procesit të vlerësimit. Si rezultat, niveli i përgjithshëm i pjesëmarrjes dhe angazhimit u rritën në ciklin e dytë të vlerësimit.

Për më tepër, ngërçi politik pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2014 në lidhje me krijimin e institucioneve të reja të Kosovës dhe formimin e qeverisë deri në dhjetor 2014, vonoi zbatimin e Aktivitetit 4 (mbështetje për hartimin e Ligjit të ri për LPP/LFT). Për ta zbutur këtë vonesë, projekti u shty pa kosto për 3 muaj deri më 30 qershor 2015, duke lejuar zbatimin e plotë të Aktivitetit 4.

Pavarësisht vështirësive të lartpërmendura dhe në sajë të veprimeve riparuese në kohë të ndërmarra nga projekti, të gjitha aktivitetet e planifikuara janë zbatuar dhe rezultatet e pritshme janë arritur me sukses.

4 VLERËSIMI I REZULTATEVE DHE ARRITJEVE TË PROJEKTIT

4.1 Arritjet sipas rezultateve të pritshme (RP)

Arritjet sipas rezultateve të pritshme janë vlerësuar duke marrë parasysh aktivitetet e zbatuara dhe treguesit objektivisht të verifikueshëm (TOV) sikurse specifikohet në kornizën logjike të projektit. Pasi që procesi i vlerësimit për komponentët e LKK dhe LPP/LFT u realizua si një proces i vetëm i unifikuar, rezultatet e nën-paragrafëve RP 1 dhe RP 2 janë të njëjta.

Përveç TOV-ve, projekti përgatiti dhe dorëzoi një gamë të produkteve të pritshme për secilin aktivitet, çka lejon të matet dhe verifikohet shkalla e zbatimit dhe suksesit të vetë aktiviteteve. Kështu, analiza e mëposhtme përmban dy nivele: shqyrtimi i TOV-ve dhe produkteve të pritshme. Produktet e pritshme janë shqyrtuar në kolonën "Veprimet/Sfidat" në tabelën e mëposhtme të aktiviteteve.

Rezultati i pritshëm 1	**Rezultati i pritshëm 2**
Vlerësimi i masave kundër korrupsionit	Vlerësimi i masave kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit

TOV

- Matrica e pajtueshmërisë e hartuar dhe miratuar nga Komiteti Drejtues;
- Termat e Referencës për vlerësimin të përgatitura dhe miratuara nga Komiteti Drejtues;
- Raporti i parë i vlerësimit, Raporti i Progresit, dhe raporti i dytë (përfundimtar) i vlerësimit janë në dispozicion;
- Sasia dhe cilësia e të dhënave dhe informacionit të prodhuar nga institucionet e Kosovës;
- Numri/shtrirja dhe diversiteti profesional i personave të trajnuar për të menaxhuar dhe për të ndjekur ushtrime ndërkombëtare të vlerësimit;
- Numri i raporteve të publikuara, përkthyera dhe numri i institucioneve të përfshira.

Të gjitha TOV-et u arritën plotësisht me përjashtim të TOV 4 (sasia dhe cilësia e të dhënave të informacionit të prodhuar nga institucionet e Kosovës), pasi cilësia e të dhënave/statistikave dhe informacioneve të prezantuara nga institucionet përfituese ndryshonin gjatë procesit të vlerësimit. Projekti ka hasur disa vështirësi në marrjen e komenteve dhe informacioneve shtesë nga disa institucione për raportet ndërmjetëse, dhe të dhënave kuptimplote për pyetësorin e ciklit të 2^{të} të LPP/LFT dhe raportet përfundimtare të vlerësimit. Projekti i adresoi këto mangësi duke shtuar përpjekjet, përmes takimeve dypalëshe dhe tryezave të rrumbullakëta, për të udhëzuar dhe shpjeguar më tej për autoritetet atë që pritej prej tyre, si dhe duke përdorur mënyra alternative të mbledhjes së informacionit. Si rezultat i kësaj, dhe me mbështetjen e NJIF-it dhe AAK-së, projekti arriti të angazhojë dhe të përfitojë më shumë të dhëna nga institucionet përfituese gjatë fazës përfundimtare të procesit të vlerësimit.

1.1 / 2.1 Raportet e vlerësimit dhe të progresit janë në dispozicion për nivelin e pajtueshmërisë së rregulloreve dhe praktikave në fuqi me standardet evropiane (bazuar në përvojën dhe kriteret e përdorura nga GRECO / MONEYVAL dhe organet e tjera përkatëse ndërkombëtare);

Pas procesit gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të vlerësimit që përbëhej nga dy cikle vlerësimi dhe rishikimit të progresit afatmesëm të kryera në bazë të metodologjive të GRECO dhe MONEYVAL të përshtatura në mënyrë specifike për kontekstin e Kosovës, dhe në përputhje me Termat e Referencës për vlerësimin të miratuara nga Komiteti Drejtues, projekti prodhoi në total 6 raporte:

- Raportet e vlerësimit (cikli 1) me analiza të thelluara të kornizave të Kosovës për LKK dhe LPP/LFT dhe përputhshmërinë e tyre me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, gjetjet dhe rekomandimet për adresimin e mangësive dhe boshllëqeve të identifikuara, të miratuara në qershor 2013;
- Raporte përcjellëse ndërmjetëse (progresi) që vlerësojnë përparimin e bërë nga autoritetet e Kosovës në zbatimin e rekomandimeve të PECK të dhëna në ciklin 1, prill 2014;
- Raportet përfundimtare të vlerësimit (cikli 2) që masin dhe përditësojnë nivelin e pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare në LKK dhe LPP/LFT, të miratuara në dhjetor të vitit 2014.

Raportet duhet të përdoren nga autoritetet dhe të gjithë aktorët që punojnë në përmirësimin e gjendjes së Krimit Ekonomik në Kosovë, si një bazë dhe udhërrëfyes për reformat e nevojshme legjislative, institucionale dhe të politikave. NjIF-K ka dorëzuar raportin e vlerësimit për LPP/LFT në Grupin Egmont në mbështetje të kërkesës për anëtarësim. Një numër i institucioneve vendore, si dhe organizata/projekte ndërkombëtare dhe burime të tjera u janë referuar gjetjeve dhe rekomandimeve të vlerësimit të PECK në raportet e tyre.[2]

1.2 / 2.2 Institucionet e Kosovës janë të afta të mbështesin dhe të kryejnë vlerësime kolegjiale për masat kundër korrupsionit, kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, bazuar në metodologjinë evropiane të monitorimit;

Projekti i kushtoi vëmendje të veçantë pronësisë vendore. U punua me pikat e kontaktit të caktuara posaçërisht për projektin brenda institucioneve përfituese dhe në veçanti, me përfaqësues të dy institucioneve kryesore koordinuese - AAK dhe NJIF, përgjegjëse për koordinimin, grumbullimin dhe shpërndarjen e informacionit mes institucioneve vendore.

---

[2] Përgjigjet e autoriteteve për pyetësorin lidhur me përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me BE-në, f.74;
Vlerësimi i Sistemit Kombëtar të Integritetit të Kosovës, tetor 2015, Instituti Demokratik i Kosovës/Transparency International Kosova, f. 11, 30, 32, 41, 43, 46-47, 55, 58, 69-71, 73-75, 84-86, 89 , 95, 97-98, 101-103, 114, 118-119, 165-168, 178, 181-182, 194, 198, 235, 239, dhe 243-244: http://www.kdi-kosova.org/;
FMN Raport i Stafit për Konsultime mbi Nenin 4 për vitin 2015 – Shtojcë informative, f. 47: https://www.imf.org/;
Skicë e projektit të UNDP-së për mbështetjen e përpjekjeve kundër korrupsionit në Kosovë (SAEK), f. 18-19: http://www.undp.org/;
Integriteti gjyqësor në Kosovë, UNODC/UNDP, 2014, f. 20: http://www.ks.undp.org/;
Vlerësimi tematik për mbështetjen IPA në luftën kundër korrupsionit, Raporti Përfundimtar i datës 5 gusht 2015 (Kontrata nr. 2014/348486/2), B&S Europe: http://www.evropa.gov.rs/;
Metodologjia për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjive kombëtare kundër korrupsionit dhe planeve të veprimit, Iniciativa Rajonale kundër Korrupsionit për Evropën Juglindore (RAI), 2015, f.21; http://rai-see.org/;
Forcimi i qeverisjes demokratike dhe besimit në shërbimet publike në Ballkanin Perëndimor, Raporti i Misionit, f.10: http://www.respaweb.eu/.

Projekti përfshiu në mënyrë aktive dhe kërkoi të dhëna prej rreth 30 institucioneve përfituese në të gjitha fazat e procesit të vlerësimit: plotësimi i pyetësorëve të vlerësimit, takime me Ekipin e Vlerësimit gjatë vizitave në terren (105 përfaqësues të 56 institucioneve vendore dhe ndërkombëtare dhe shoqërisë civile u takuan gjatë vizitës në terren të ciklit të 2[të]), dhënia e komenteve dhe informatave shtesë në raportet e vlerësimit, diskutimi dhe miratimi i raporteve. Projekti ofroi këshilla dhe udhëzime të vazhdueshme për institucionet përfituese përmes seancave/workshopeve/takimeve të shumta informative dypalëshe dhe shumëpalëshe që shpjeguan procesin e vlerësimit dhe metodologjinë, mbledhjen e statistikave, praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra. Mbi 50 pika kontakti nga institucionet përfituese janë trajnuar për të menaxhuar dhe për të mbështetur ushtrimet ndërkombëtare të vlerësimit. Veprimtaritë dhe ndërhyrjet e mësipërme kontribuan në ndërtimin dhe/ose rritjen e kapaciteteve institucionale të institucioneve përfituese për të mbështetur dhe kryer vlerësime kolegjiale për masat e LKK dhe LPP/LFT bazuar në metodologjinë evropiane të monitorimit. Në përgjithësi, shumica e përfituesve demonstruan kapacitete të përshtatshme në këtë drejtim, edhe pse disa prej tyre ishin më pak aktive në faza të ndryshme të vlerësimit (p.sh. disa prej institucioneve nuk dhanë asnjë informacion/koment mbi raportet ndërmjetëse ose cilësia e informacionit të dhënë nuk ka qenë e kënaqshme).

1.3 / 2.3 Rekomandimet janë në dispozicion për fushat rregullatore, institucionale dhe të politikave të lidhura;

Bazuar në vlerësimin gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të modeluar sipas vlerësimeve të GRECO dhe MONEYVAL, projekti ka dhënë rekomandime konkrete në fushat e lidhura me politikat, kuadrin rregullator dhe institucional në fushat e LKK dhe LPP/LFT. Për komponentin e LKK, janë dhënë 62 rekomandime me qëllim adresimin e mangësive të identifikuara në lidhje me garancitë themelore, masat parandaluese dhe represive për të luftuar në mënyrë efikase dhe parandaluar korrupsionin (të gjitha temat e mbuluara nga katër roundet e vlerësimit të GRECO-s) në përputhje me standardet ndërkombëtare. Përveç kësaj, u përgatit një matricë e pajtueshmërisë për të ndjekur progresin në zbatimin e rekomandimeve. Për komponentin e LPP/LFT, u përpunua një plan i hollësishëm veprimi me qëllim për të përmirësuar dhe forcuar më tej regjimin e LPP/LFT në Kosovë. Përveç ofrimit të udhëzimeve konkrete për reformat e nevojshme, rekomandimet e PECK formojnë një bazë solide për riorganizimin e ndihmës ndërkombëtare në Kosovë në fushën e krimit ekonomik.

1.4 / 2.4 Vlerësimi dhe raportet e progresit (përfshirë matricën e pajtueshmërisë) janë publikuar dhe shpërndarë në anglisht, shqip dhe serbisht.

Të gjashtë raportet e nxjerra nga Projekti PECK, përfshirë matricën e pajtueshmërisë për komponentin e LKK, në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe janë botuar dhe shpërndarë gjerësisht për të gjitha palët e interesuara përkatëse vendore dhe ndërkombëtare. Raportet janë publikuar fillimisht në faqen e internetit të projektit (www.coe.int/peck) dhe deri më sot janë gjithashtu në dispozicion në faqet e internetit të shumicës së institucioneve përfituese (Qeveria, Kuvendi, NjIF, AAK, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Gjykata Supreme, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prokuroria e Shtetit, Inspektorati Policor i Kosovës, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe

Organi Shqyrtues i Prokurimit). Përveç kësaj, projekti siguroi publikimin e raporteve përfundimtare të vlerësimit në kopje në letër dhe i shpërndau gjerësisht ato tek të gjitha palët e interesuara, përfshirë organizatat ndërkombëtare, sektorin privat, shoqërinë civile dhe mediat në aktivitetin e promovimit të nivelit të lartë që u mbajt së bashku me konferencën përmbyllëse të projektit më 28 prill 2015.

4.2 Qëllimi i projektit: Vlerësimi i zbatimit

TOV

- Shkalla në të cilën legjislacioni, politikat, organizatat dhe kapacitetet janë në përputhje me standardet evropiane
- Numri dhe seriozitetí/shumëllojshmëria e lëndëve të raportuara, të hetuara, të ndjekura penalisht dhe të gjykuara
- Numri dhe shtrirja e rekomandimeve nga zbatimi i analizës së rrezikut
- Numri/shtrirja dhe diversiteti profesional i personave të trajnuar për të menaxhuar dhe ndjekur ushtrime ndërkombëtare të vlerësimit

Arritja e rezultateve të pritshme kontribuoi në arritjen e qëllimit të projektit, domethënë forcimi i kapaciteteve institucionale për të luftuar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë në përputhje me standardet evropiane përmes vlerësimeve të plota dhe rekomandimeve për përmirësimin dhe riorganizimin e reformave kundër krimit ekonomik. Projekti ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në disa reforma legjislative: ndryshimet në Ligjin për financimin e subjekteve politike, nisjen e vlerësimit të rrezikut kombëtar për LPP/LFT, rishikimi i ligjit për LPP/LFT adresoi disa nga rekomandimet e vlerësimit. Disa nisma legjislative të frymëzuara nga rekomandimet e PECK janë finalizuar, ose janë aktualisht në shqyrtim parlamentar.[3] Duke përfshirë aktivisht dhe duke kërkuar të dhëna nga pikat e kontaktit në mbi 30 institucione përfituese (ministritë kryesore, institucionet qendrore dhe agjencitë ekzekutive, organet e zbatimit të ligjit, gjyqësori dhe sektori financiar) në të gjitha aktivitetet e tij, projekti forcoi kapacitetet e tyre dhe i trajnoi për të menaxhuar dhe ndjekur më tej ushtrimet ndërkombëtare të vlerësimit.

Me gjithë zhvillimet e mësipërme pozitive, niveli i përgjithshëm i zbatimit të rekomandimeve të PECK në fund të projektit ishte mjaft i ulët. Për komponentin e LKK, nga 62 rekomandime vetëm 5 janë zbatuar në mënyrë të kënaqshme apo janë trajtuar në mënyrë të kënaqshme; 25 janë zbatuar pjesërisht dhe 32 rekomandime (ose 51.6%) nuk janë zbatuar. Për komponentin e LPP/LFT, nga 40 + 9 rekomandimet e FATF-së, vetëm 2 janë klasifikuar si në përputhje (P), 8 si kryesisht në përputhje (KP), 22 si pjesërisht në përputhje (PP) dhe 14

[3] Paketa e ligjeve të drejtësisë, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve për gjykatat, prokurorin i shtetit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, që u miratua më 28 maj 2015; projektligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik dhe për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të cilat janë ende në procedurë të Kuvendit. Të gjitha këto akte legjislative kanë si shkak të pjesshëm disa nga rekomandimet e raporteve të vlerësimit të PECK dhe/ose adresojnë pjesërisht disa prej tyre.

mospërputhje (MP). 3 Rekomandime të FATF-së janë konsideruar të pazbatueshme (PZ) në kontekstin e Kosovës.

Përpjekje më të fuqishme dhe të qëndrueshme janë të nevojshme për të zbatuar rekomandimet e mbetura. Kjo do të kërkojë angazhim të fortë politik, përveç masave të koordinuara, prioritare dhe efektive që duhet të ndërmerren pa vonesë të mëtejshme. Pas zbatimit, përputhshmëria me standardet ndërkombëtare për LKK dhe LPP/LFT do të rritet në mënyrë të konsiderueshme, dhe kapacitetet institucionale për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit do të ngrihen më tej. Në konferencën përmbyllëse të Projektit, autoritetet e Kosovës përsëritën angazhimin e tyre të vendosur për zbatimin e rekomandimeve të mbetura. Mbetet për t'u parë nëse ata do të jenë në gjendje të ndërmarrin reformat e nevojshme.

Raporti për Kosovën 2015 i BE-së u bën jehonë gjetjeve dhe rekomandimeve të Projektit:

"Kosova është në një fazë të hershme në luftën kundër korrupsionit. Disa përparime janë arritur gjatë vitit të kaluar, sidomos në bashkëpunim të përmirësuar ndërmjet Agjencisë kundër Korrupsionit dhe prokurorisë, dhe në deklarimin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve. Megjithatë, progresi i përgjithshëm ka qenë i kufizuar dhe kërkohet vullnet i fortë politik dhe angazhim i nevojshëm për ta trajtuar si duhet këtë fenomen. Një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike është e nevojshme për të siguruar rezultate reale në luftën kundër korrupsionit endemik në Kosovë. Regjistrimi i rezultateve të ndjekjes penale dhe dënimeve të suksesshme do të përfaqësonin përparim të vërtetë. Në adresimin e mangësive të përshkruara më poshtë, qeveria e Kosovës duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë gjatë vitit të ardhshëm:

- *prioritizimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, sidomos në prokurimin publik, me qëllim që të sigurohen dënime përfundimtare;*
- *forcimit të bashkëpunimit mes policisë dhe prokurorisë nëpërmjet ekipeve të përbashkëta hetimore në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë;*
- *përfundimit të zhvillimit të një sistemi efikas për monitorimin e regjistrimit të rezultateve të trajtimit të lëndëve nga hetimi deri tek vendimet përfundimtare të gjykatës;*
- *rishikimit të ligjit të konfliktit të interesit dhe të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të lidhura për t'i harmonizuar me standardet evropiane. Në veçanti, duhet të përcaktohen qartë kategoritë e zyrtarëve publikë dhe duhet të miratohen masat për parandalimin dhe sanksionimin e konfliktit të interesave dhe rregullimin e "migrimit abuziv nga sektori publik në atë privat".*

[…]

"Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare 2014-2018 po ecën sipas planit... Zbatimi i ligjeve në fuqi, akteve nënligjore dhe rregulloreve ***për pastrimin e parave dhe krimin financiar*** *është ende i pamjaftueshëm, pavarësisht progresit në vendosjen e sistemeve të përshtatshme. Ka një politikë për* ***hetimet financiare*** *të rënda në mënyrë sistematike, por mungojnë rezultatet. Shkalla e* ***sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive kriminale*** *mbetet e ulët.*

Plani i veprimit për vlerësimin e rrezikut kombëtar për pastrimin e parave dhe luftën kundër terrorizmit financiar u zbatua kryesisht në kohë. Në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave, korniza ligjore e Kosovës është kryesisht në përputhje me Konventat e Vjenës dhe Palermos.

Megjithatë, mbeten mangësi të caktuara, për shembull në deklarimin e pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë dhe në manipulimin e tregut.

Bashkëpunimi ndërmjet Njësisë së Inteligjencës Financiare në Ministrinë e Financave dhe organeve kyçe në zinxhirin kundër pastrimit të parave duhet të përmirësohet më tej. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi më i mirë, në veçanti me policinë dhe prokurorinë, është me rëndësi jetike. Departamenti kundër korrupsionit në Prokurorinë Speciale të Kosovës duhet të forcohet për të trajtuar më shumë lëndë kundër pastrimit të parave, në bashkëpunim me Misionin e Sundimit të Ligjit të BE-së, EULEX. Ka pasur një rritje të numrit të rasteve kundër pastrimit të parave të dërguara në prokurori. Megjithatë, ka pasur pak dënime deri më sot. Bashkëpunimi mes prokurorisë dhe policisë duhet të forcohet. Kosova duhet të bëjë përpjekje të harmonizojë legjislacionin dhe praktikat e saj sipas rekomandimeve të FATF-së."

4.3 Vlerësimi i produkteve të dorëzuara të projektit

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
Aktiviteti 1: Organizimi i vlerësimit (cikli i 1rë) të masave kundër korrupsionit dhe LPP/LFT			
1.1 - Konsultim dhe këshillim për institucionet në Kosovë për raportimin gjatë procesit të vlerësimit	▪ Mbi 50 pika kontakti në institucionet përfituese u trajnuan lidhur me raportimin për qëllime të vlerësimit	Përfunduar	**Veprimet** Ekipi i Projektit ka dhënë udhëzime të vazhdueshme dhe këshillim për institucionet përfituese përmes takimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, sesioneve shpjeguese/informative dhe workshopeve për metodologjinë dhe ecurinë e procesit të vlerësimit, përfshirë raportimin e statistikave.
1.2 - Përgatitja e pyetësorëve për LKK dhe LPP/LFT në përputhje me metodologjitë e vlerësimit të GRECO dhe MONEYVAL	▪ Pyetësorët e vlerësimit për komponentët e LKK dhe LPP/LFT të përgatitur në bazë të metodologjive të GRECO dhe MONEYVAL	Përfunduar	**Veprimet** Projekti përgatiti pyetësorët e vlerësimit për komponentët e LKK dhe LPP/LFT të përgatitur në bazë të metodologjive të GRECO dhe MONEYVAL. Pyetësori për LKK mbuloi të gjitha temat e adresuara nga GRECO në katër raunde të vlerësimit; pyetësori për LPP/LFT trajtoi 29 (nga 49) Rekomandime të FATF-së, dispozita të caktuara të Konventës së Varshavës së

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
			Këshillit të Evropës dhe direktivës së BE-së për LPP.
1.3 - Përkthimi i pyetësorëve për LKK dhe LPP/LFT në gjuhën shqipe dhe serbe	▪ Pyetësorët për LKK dhe LPP/LFT janë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe serbe	Përfunduar	**Veprimet** Projekti përktheu dhe korrektoi pyetësorët për LKK dhe LPP/LFT në gjuhën shqipe dhe serbe
1.4 - Organizimi i një seminari shpjegues për autoritetet në Kosovë për mbledhjen e të dhënave dhe përgatitjen e përgjigjeve për pyetësorët e vlerësimit	▪ U organizuan takimet shpjeguese / seminare; ▪ U takuan mbi 70 përfaqësues të institucioneve përfituese ▪ U shpërnda përmbledhja e hartuar e standardeve ndërkombëtare për LKK dhe LPP/LFT në anglisht dhe në shqip	Përfunduar	**Veprimet** Një sërë takimesh shpjeguese janë mbajtur në datat 10-12 korrik 2012 për të paraqitur dhe shpjeguar aspektet thelbësore të pyetësorëve për LKK dhe LPP/LFT, si dhe ecurinë e procesit të vlerësimit. Në periudhën korrik-shtator, Këshilltari i Projektit zhvilloi takime dypalëshe me homologët për të diskutuar përmbajtjen e pyetësorëve të vlerësimit, procesin për të organizuar dhe të koordinuar mbledhjen dhe sistematizimin e përgjigjeve nga ana e autoriteteve, përfshirë rolet specifike të dy agjencive kryesuese - AKK dhe NjIF; **Veprimet plotësuese** Projekti hartoi dhe shpërndau standardet ndërkombëtare për LKK dhe LPP/LFT te institucionet përfituese në anglisht dhe në shqip
1.5 - Shpërndarja e pyetësorëve për LKK dhe LPP/LFT për secilin autoritet përgjegjës dhe përkatës në Kosovë	▪ Pyetësorët për LKK dhe LPP/LFT në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe u shpërndanë në të gjitha institucionet përfituese	Përfunduar	**Veprimet** Në shtator 2012, pyetësorët e vlerësimit u shpërndanë përmes AKK-së dhe NjIF-it tek të gjitha institucionet përfituese me një kërkesë për të paraqitur përgjigjet brenda 2 muajve.
1.6 - Përkthimi (sipas nevojës) i përgjigjeve të Kosovës për pyetësorët e vlerësimit	▪ Përgjigjet e autoriteteve për pyetësorët e vlerësimit të përkthyera në	Përfunduar	**Veprimet** Përgjigjet e autoriteteve për pyetësorët e vlerësimit janë përkthyer në anglisht dhe iu kaluan Ekipit të Vlerësimit për

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
	anglisht		analizën dhe përgatitjen e vizitës në terren.
1.7 - Organizimi i vizitës/vizitave në terren të ekspertëve të ekipit të vlerësimit në Kosovë me qëllim kryerjen e intervistave dhe mbledhjen e informatave në bazë të përgjigjeve të pyetësorit	▪ U krye vizita në terren ▪ U takuan përfaqësuesit e mbi 50 institucioneve vendore dhe ndërkombëtare	Përfunduar	**Veprimet** Vizita në terren u zhvillua në dy faza, në fund të nëntorit - fillim të dhjetorit të vitit 2012, dhe ka përfshirë takime me një gamë të gjerë të institucioneve kryesore në Kosovë. Qëllimi i vizitës ishte për të verifikuar dhe qartësuar përgjigjet e dhëna në pyetësorët e vlerësimit dhe mbledhur informata shtesë për hartimin e raporteve të vlerësimit.
Veprimi 1.8 - Përgatitja e projektraportit të vlerësimit (përfshirë rekomandimet dhe matricën e pajtueshmërisë) nga ekipi i ekspertëve dhe shkëmbimi i të dhënave me autoritetet në Kosovë në lidhje me gjetjet	▪ Raportet e vlerësimit për LKK dhe LPP/LFT u hartuan dhe diskutuan me 25 përfaqësues të institucioneve kryesore përfituese dhe 2 përfaqësues të EULEX-it	Përfunduar	**Veprimet:** Bazuar në përgjigjet në pyetësorët dhe informacionin e mbledhur gjatë vizitës në terren dhe kontributeve nga autoritetet, Ekipi i Vlerësimit hartoi raportet e vlerësimit me analizë të thellë të kornizave të LKK dhe LPP/LFT dhe rekomandimet për të adresuar mangësitë e identifikuara. Projektraportet u janë shpërndarë autoriteteve për komente dhe janë diskutuar në detaje gjatë takimit sy më sy të mbajtur në Strasburg më 29-30 prill 2013.
Veprimi 1.9 - Përkthimi i projektraportit të vlerësimit	▪ Projektraportet për LKK dhe LPP/LFT janë përkthyer në shqip	Përfunduar	**Veprimet** Projektraportet janë përkthyer në shqip
Veprimi 1.10 - Përmbyllja dhe shqyrtimi kolegjial i projektraportit të vlerësimit në Konferencën Plenare	▪ U mbajt mbledhja plenare; ▪ Raportet e vlerësimit për LKK dhe LPP/LFT (186 dhe 297 faqe përkatësisht) u rishikuan, finalizuan dhe u	Përfunduar	**Veprimet** Raportet e vlerësimit janë diskutuar më tej, shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen plenare të mbajtur në Prishtinë më 10 Qershor 2013 me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara.

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
	miratuan me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të mbi 30 institucioneve përfituese		
Veprimi 1.11 - Përkthimi i raportit të vlerësimit të miratuar në Konferencën Plenare	▪ Raportet e vlerësimit të përkthyera në gjuhët shqipe dhe serbe	Përfunduar	**Veprimet** Projekti siguroi përkthimin dhe korrektimin e raporteve të përfunduara të vlerësimit në gjuhët shqipe dhe serbe
Veprimi 1.12 - Publikimi i raportit nga autoritetet në Kosovë. Aktivitet promovimi për shoqërinë civile me pjesëmarrjen e mediave për të shpjeguar gjetjet e vlerësimit	▪ U organizua aktiviteti promovues i nivelit të lartë; ▪ Mbi 50 përfaqësues të palëve të interesuara vendore dhe ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe mediave morën pjesë në konferencë; ▪ Raportet e vlerësimit të LKK dhe LPP/LFT janë në dispozicion në faqen e projektit në gjuhët angleze, shqipe dhe serbe, si dhe në faqet e internetit të shumicës së institucioneve përfituese.	Përfunduar	**Veprimet** Aktiviteti promovues i nivelit të lartë (11 qershor 2013) prezantoi gjetjet kryesore dhe rekomandimet e raporteve të vlerësimit për një gamë të gjerë të palëve të interesuara vendore dhe ndërkombëtare, sektorin financiar, shoqërisë civile dhe mediat. Ky aktivitet u raportua gjerësisht në mediat lokale. Projekti publikoi raportet e vlerësimit në faqen e tij të internetit në fund të nëntorit 2013, pas vendimit të arritur në takimin e Komitetit Drejtues të Projektit. **Sfidat** Marrja e autorizimit zyrtar për publikimin e raporteve të vlerësimit rezultoi të jetë e vështirë. Prandaj, kjo çështje u diskutua në takimin e 4^{të} të Komitetit Drejtues të Projektit (29 tetor 2013) dhe u vendos të publikohen raportet e vlerësimit në faqen e internetit të Projektit, me kusht që përfituesit të mos shprehnin ndonjë kundërshtim brenda dy javësh. Institucionet u inkurajuan që raportet t'i vinin në dispozicion në faqet e

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
			internetit të tyre. Disa prej tyre iu desh mjaft kohë për ta bërë këtë.
Veprimi 1.13 - Dy seminare mbi praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra në lidhje me pjesëmarrjen e autoriteteve të Kosovës në procesin e vlerësimit, përfshirë çështjet e mbledhjes së të dhënave, mbajtjen dhe raportimin e statistikave për qëllime të vlerësimit	▪ Dy seminare të organizuara me pjesëmarrjen e përkatësisht 25 dhe 40 personave; ▪ Raporti mbi seminarin e 1 rë në dispozicion; ▪ Prezantime të ekspertëve mbi praktikat më të mira në Mbretërinë e Bashkuar dhe Holandë në dispozicion; ▪ Dokument teknik për Statistikat interaktive për Krimin Ekonomik në Kosovë, i përgatitur dhe shpërndarë tek të gjitha palët e interesuara në anglisht dhe shqip.	Përfunduar	**Veprimet** Workshopi i 1rë (30 tetor 2013) u lejoi autoriteteve të Kosovës që të diskutojnë mbi mësimet e nxjerra nga ciklit i 1rë i vlerësimit dhe të përditësojnë projektin mbi progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit. Raporti që përmbledh gjetjet kryesore të workshopit u nda me Ekipin e Vlerësimit. Workshopi ka kontribuar në përgatitjen e projektraporteve të progresit, dhe në rritjen e kapaciteteve të institucioneve përfituese për të menaxhuar dhe për të ndjekur ushtrime ndërkombëtare të vlerësimit. Workshopi i 2të (26-27 shkurt 2014) u përqendrua në mbledhjen e të dhënave, mirëmbajtjen dhe raportimin e statistikave, pasi mungesa e statistikave të besueshme dhe gjithëpërfshirëse është identifikuar si një nga mangësitë kryesore në procesin e vlerësimit. Si rezultat, dokumenti teknik është përgatitur me udhëzime praktike dhe rekomandime për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit të statistikave të besueshme, interaktive dhe të integruara për ndjekjen dhe gjetjen e rasteve të krimit ekonomik në bazë të praktikave të mira në Mbretërinë e Bashkuar dhe Holandë.
Veprimi 1.14 - Organizimi i një workshopi	▪ Workshopi u organizua; ▪ Morën pjesë 43	Përfunduar	**Veprimet** Workshopi (3-4 dhjetor 2013) prezantoi dhe diskutoi

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
ndërinstitucional për autoritetet në Kosovë për të siguruar një kuptim të unifikuar të reformave të propozuara	përfaqësues të institucioneve përfituese; ▪ U nis cikli i 2[të] i vlerësimit.		projektraportet paraprake mbi përparimin e bërë nga autoritetet në zbatimin e rekomandimeve të ciklit të 1[rë] për të siguruar një kuptim të unifikuar të reformave të propozuara. **Veprimet shtesë** Workshopi shërbeu për të nisur zyrtarisht ciklin e 2[të] të vlerësimit dhe të paraqesë pyetësorin e ciklit të 2[të] të LPP/LFT dhe matricën e pajtueshmërisë për LKK
Veprimi 1.15 - Vizitë studimore për të nxitur bashkëpunimin dypalësh në fushën e LKK	▪ Vizita studimore e organizuar; ▪ Morën pjesë 9 përfaqësues të institucioneve kryesore të përfshira në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit; ▪ Bashkëpunimi me homologët italianë u zgjerua.	Përfunduar	**Veprimet** Vizita studimore në Itali (14-16 korrik 2014) u lejoi pjesëmarrësve të Kosovës që të shkëmbejnë përvojën dhe njohuritë me homologët e tyre italianë dhe të forcojnë më tej bashkëpunimin dypalësh.
Veprimi 1.16 - Konferencë ndërkombëtare për bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet NJIF-eve, prokurorëve dhe organeve të zbatimit të ligjit	▪ Konferenca ndërkombëtare e organizuar; ▪ 50 pjesëmarrës nga NJIF-e vendas dhe të huaj, prokuroria dhe autoritetet e zbatimit të ligjit morën pjesë në aktivitet; ▪ Materialet dhe konkluzionet e konferencës në dispozicion; ▪ Bashkëpunimi ndërkombëtar u zgjerua.	Përfunduar	**Veprimet** Konferenca (23 shtator 2014) u lejoi pjesëmarrësve që të shkëmbejnë përvojat praktike, praktikat e mira dhe këshilla nga homologë për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndihmën e ndërsjellë juridike në luftimin dhe parandalimin e PP dhe FT. Përfaqësues nga Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Gjermania, Hungaria, Italia, Mali i Zi dhe Mbretëria e Bashkuar ndanë përvojën e tyre dhe paraqitën raste studimore praktike të ndjekura nga diskutime të frytshme. Edhe përfaqësuesit e Policisë së Kosovës dhe

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
			Ministrisë së Drejtësisë prezantuan punën e tyre.
Veprimi 1.17 - Mbështetje e përgjithshme për autoritetet e Kosovës në zbatimin e rekomandimeve nga raporti i vlerësimit	▪ Mbështetje e vazhdueshme dhe udhëzime për institucionet përfituese; ▪ Dokument këshillimor për projekt-ndryshimet në ligjin për konfliktin e interesit.	Përfunduar	**Veprimet** Projekti ka ofruar përkrahje të vazhdueshme dhe udhëzime për institucionet përfituese në zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit përmes takimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, seminareve, etj. **Veprimi shtesë** Në dhjetor të vitit 2013, projekti përgatiti Dokumentin Këshillues mbi projekt-ndryshimet në ligjin për konfliktin e interesit, me kërkesën e AAK-së, si udhëzim për zbatimin e rekomandimeve përkatëse të PECK.
Aktiviteti 2. Përgatitja e raportit të progresit për masat e ndërmarra nga autoritetet e Kosovës për të zbatuar rekomandimet e ciklit të parë të vlerësimit			
Veprimi 2.1 - Mbledhja e informacionit, përfshirë edhe raporte të ndryshme të BE-së (Raporti i Progresit, udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave, Marrëveshja e Stabilizim Asocimit), të nevojshëm për përgatitjen e raportit të progresit nga ekipi i ekspertëve	▪ Informatat e mbledhura	Përfunduar	**Veprimet** Projekti mblodhi informacion për përgatitjen e raporteve ndërmjetëse (të progresit) nga burime të hapura dhe institucionet përfituese. Veprimet 1.12 dhe 1.14 (shih më lart) kontribuan në këtë proces.
Veprimi 2.2 - Hartimi i raportit të progresit nga ekipi i ekspertëve	▪ Raportet ndërmjetëse (të progresit) për LKK dhe LPP/LFT u hartuan dhe diskutuan me institucionet përfituese	Përfunduar	**Veprimet** Në nëntor të vitit 2013, Ekipi i Vlerësimit hartoi raportet ndërmjetëse (të progresit) të cilat vlerësojnë progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të ciklit të 1rë mbi bazën e informacionit të mbledhur nga burime të hapura dhe të dhëna të kufizuara të ofruara nga

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
			institucionet përfituese. Projektraportet u diskutuan me autoritetet gjatë workshopit ndërinstitucional (shih veprimin 1.14 lart) dhe u shpërndanë për komente dhe informata shtesë nga institucionet përfituese përmes AKK-së dhe NjIF-it më 20 dhjetor 2013.
Veprimi 2.3 - Përmbyllja dhe përkthimi i raportit, botimi	▪ Raportet për LKK dhe LPP/LFT u përmbyllën dhe u publikuan në gjuhët angleze, shqipe dhe serbe, përfshirë matricën e përputhshmërisë për LKK, në faqen e internetit të projektit dhe faqet e internetit të shumicës së institucioneve përfituese; ▪ Rreth 30 institucione përfituese kontribuan në përgatitjen e raporteve në shkallë të ndryshme.	Përfunduar	**Veprimet** Raportet u përmbyllën dhe u përkthyen në gjuhët shqipe dhe serbe në prill të vitit 2014. Ato janë botuar në qershor 2014 pas zgjedhjeve të përgjithshme (8 qershor 2014), në mënyrë që të shmanget ndonjë përdorim i mundshëm i papërshtatshëm apo interpretim nga ana e mediave apo aktorëve politikë. **Sfidat** Për shkak të sasisë dhe cilësisë së kufizuar të të dhënave/informacionit të dhënë nga autoritetet për projektraportet ndërmjetëse (të progresit), afati i fundit për dorëzimin e komenteve dhe informatave shtesë është dashur të shtyhet deri më 14 shkurt 2014. Projekti përdori çdo mundësi (takime dypalëshe, seminare, etj.) për të theksuar rëndësinë e sigurimit të informacionit të kërkuar që do të tregojë përparimin e bërë. Megjithatë, pavarësisht nga përpjekjet më të mira të bëra, mjaft institucione nuk ofruan ndonjë informacion apo dhanë informacion që nuk ishte drejtpërdrejt me rëndësi.

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
Aktiviteti 3. Organizimi i vlerësimit (cikli i 2rë) për masat kundër korrupsionit dhe LPP/LFT			
Veprimi 3.1 - Përgatitja e pyetësorit/matricës së pajtueshmërisë së ciklit të 2të për LKK dhe LPP/LFT në bazë të rezultateve dhe rreziqeve të identifikuara gjatë ciklit të parë të vlerësimit.	▪ U përgatit pyetësori për LPP/LFT; ▪ Matrica e pajtueshmërisë për LKK në dispozicion.	Përfunduar	**Veprimet** Projekti përgatiti pyetësorin e ciklit të dytë për LPP/LFT që mbulon rekomandimet e FATF-së që nuk u adresuan në ciklin 1. U përgatit matrica e pajtueshmërisë për LKK për të ndjekur progresin në zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit.
3.2 - Përkthimi i pyetësorit për LPP/LFT dhe matricës së pajtueshmërisë për LKK në gjuhët shqipe dhe serbe	▪ Pyetësori për LPP/LFT dhe matrica e pajtueshmërisë për LKK në dispozicion në shqip dhe serbisht	Përfunduar	**Veprimet** Projekti përktheu dhe korrektoi pyetësorin për LPP/LFT dhe matricën e pajtueshmërisë për LKK në gjuhët shqipe dhe serbe
3.3 - Shpërndarja e pyetësorit/matricës së pajtueshmërisë për LKK dhe LPP/LFT për secilin autoritet përgjegjës dhe përkatës në Kosovë	▪ U shpërndanë matrica e pajtueshmërisë për LKK dhe pyetësori për LPP/LFT	Përfunduar	**Veprimet** Pyetësori i ciklit të 2të për LPP/LFT është prezantuar dhe shpërndarë për përfituesit gjatë seminarit ndërinstitucional në datat 3-4 dhjetor 2013 (shih Veprim 1.14 më sipër).
Veprimi 3.4 - Përkthimi (sipas nevojës) i përgjigjeve të Kosovës për pyetësorët e vlerësimit	▪ U përkthyen përgjigjet e autoriteteve	Përfunduar	**Veprimet** Përgjigjet e autoriteteve për pyetësorin e vlerësimit janë përkthyer në anglisht dhe iu kaluan Ekipit të Vlerësimit për analizën dhe përgatitjen e vizitës së 2të në terren.
Veprimi 3.5 - Organizimi i vizitës/vizitave në terren të ekipit të ekspertëve në Kosovë me qëllimin e kryerjes së intervistave dhe mbledhjes së informatave në bazë të përgjigjeve të pyetësorit	▪ U organizua vizita e 2të në terren ▪ U takuan 105 përfaqësues të mbi 56 institucioneve vendore dhe ndërkombëtare ▪ U mblodhën informacione/të dhëna shtesë.	Përfunduar	**Veprimet** Vizita e 2të në terren (14-18 prill 2014) ka shërbyer për të verifikuar dhe kontrolluar përgjigjet e dhëna në Pyetësorin për LPP/LFT dhe për të mbledhur informacion shtesë dhe të përditësuar mbi zbatimin e rekomandimeve të cilit 1 për të dy komponentët - LKK dhe LPP/LFT.

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
			Sfidat Informacion/të dhëna të kufizuara të ofruara nga institucionet në Pyetësorin për LPP/LFT; mungesa e statistikave kuptimplota.
Veprimi 3.6 - Përgatitja e projektraportit të vlerësimit (përfshirë rekomandimet dhe matricën e pajtueshmërisë) nga ekipi i ekspertëve dhe shkëmbimi i të dhënave me autoritetet në Kosovë në lidhje me gjetjet	▪ U hartuan raportet e vlerësimit dhe u shpërndanë për përfituesit për komente	Përfunduar	**Veprimet** Në qershor të vitit 2014, Ekipi i Vlerësimit hartoi raportet përfundimtare të vlerësimit në bazë të përgjigjeve të pyetësorit dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitës në terren. Projektraportet iu shpërndanë institucioneve përfituese për komente përmes AKK-së dhe NJIF-it në fillim të shtatorit 2014. AAK dhe NjIF koordinuan mbledhjen e komenteve/kontributeve nga institucionet përfituese dhe i dorëzuan përgjigjet e konsoliduara në tetor-nëntor 2014.
Veprimi 3.7 - Përkthimi i projektraportit të vlerësimit	▪ Projektraportet e vlerësimit u përkthyen	Përfunduar	**Veprimet** Në gusht të vitit 2014, projektraportet përfundimtare të vlerësimit u përkthyen në gjuhën shqipe me qëllim që t'iu dërgohen institucioneve përfituese për komente.
Veprimi 3.8 - Përmbyllja dhe shqyrtimi kolegjial i projektraportit të vlerësimit në Konferencën Plenare	▪ Raportet përfundimtare të vlerësimit u përmbyllën, rishikuan, shqyrtuan dhe miratuan në mbledhjen plenare; ▪ 67 përfaqësues të organizatave vendore dhe ndërkombëtare	Përfunduar	**Veprimet** Raportet përfundimtare të vlerësimit u përmbyllën nën dritën e komenteve të marra nga autoritetet dhe u diskutuan më tej, u rishikuan, u shqyrtuan dhe u miratuan në mbledhjen plenare (2-3 dhjetor 2014) me përfshirjen aktive të palëve të interesuara vendase dhe ndërkombëtare.

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
	kanë marrë pjesë në mbledhjen plenare.		
Veprimi 3.9 - Përkthimi i raportit të vlerësimit të miratuar në Konferencën Plenare	▪ Raportet përfundimtare të vlerësimit të përkthyera në gjuhët shqipe dhe serbe	Përfunduar	**Veprimet** Raportet përfundimtare të vlerësimit të miratuara në seancën plenare u korrektuan dhe u përkthyen në gjuhët shqipe dhe serbe
Veprimi 3.10 - Publikimi i raportit nga autoritetet në Kosovë. Aktivitet promovues për shoqërinë civile me pjesëmarrjen e mediave, ku shpjegohen gjetjet e vlerësimit	▪ Raportet përfundimtare të vlerësimit për LKK dhe LPP/LFT (përkatësisht 196 dhe 408 faqe) u botuan dhe u shpërndanë gjerësisht; ▪ U organizua aktiviteti promovues i nivelit të lartë; ▪ U prezantuan gjetjet e raporteve përfundimtare të vlerësimit; ▪ 66 pjesëmarrës nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, shoqëria civile dhe mediat morën pjesë.	Përfunduar	**Veprimet** Raportet përfundimtare të vlerësimit në gjuhët angleze, shqipe dhe serbe janë botuar (kopje në letër dhe publikim në internet) dhe shpërndarë gjerësisht në aktivitetin promovues të nivelit të lartë të mbajtur së bashku me konferencën përmbyllëse të Projektit më 28 prill 2015. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore, si dhe mësimet e nxjerra nga ushtrimi i vlerësimit iu prezantuan një game të gjerë të palëve të interesuara vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë shoqërinë civile dhe mediat. Raportet përfundimtare të vlerësimit në tri gjuhë janë në dispozicion në faqen e internetit të Projektit dhe faqet e internetit të shumicës së institucioneve përfituese.
Veprimi 3.11 - Konferencë ndërkombëtare për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e luftës kundër korrupsionit	▪ U organizua konferenca; ▪ 50 pjesëmarrës nga institucione kundër korrupsionit vendase dhe të huaja, prokuroria dhe autoritetet e zbatimit të ligjit morën pjesë në	Përfunduar	**Veprimet** Konferenca ndërkombëtare (28 tetor 2014) u lejoi pjesëmarrësve që të shkëmbejnë përvoja, praktika të mira dhe këshilla nga homologët për bashkëpunimin në fushën e LKK, duke u përqendruar në masa të ndryshme specifike të LKK që synojnë në luftimin dhe parandalimin mënyrë efektive të

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
	konferencë; ▪ Materialet e konferencës u vunë në dispozicion dhe iu shpërndanë të gjithë pjesëmarrësve; ▪ Bashkëpunimi ekzistues u zgjerua dhe u vendosën kontakte të reja.		korrupsionit. Përfaqësues të organeve të LKK, prokurorisë dhe organeve të zbatimit të ligjit nga Kosova, Shqipëria, Austria, Kroacia, Letonia, Lituania, Sllovenia dhe "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" bënë prezantime të ilustruara me raste studimore praktike të ndjekura nga diskutimet.
Veprimi 3.12 - Konferenca përfundimtare për praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra nga procesi i vlerësimit	▪ Konferenca përfundimtare e organizuar	Përfunduar	**Veprimet** Shih veprimin 3.10 më lart.
Aktiviteti 4. Mbështetja e përgatitjes së ligjit të ri për LPP/LFT			
Veprimi 4.1 - Ngritja e Grupit të Punës të përbërë nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë dhe takimet me të	▪ Komente mbi Koncept Dokumentin për rishikimin e ligjit për LPP/LFT në dispozicion; ▪ U ngrit Grupi i Punës; ▪ U organizuan 3 workshope; ▪ Raporti i workshopit në dispozicion.	Përfunduar	**Veprimet** Ky aktivitet u shtua në planin e punës të projektit për periudhën e zgjatjes në konsultim me institucionet përfituese dhe Zyrën e BE-së. Projekti dha komente të detajuara për Koncept Dokumentin për procesin e rishikimit të ligjit për LPP/LFT, përfshirë ngritjen e Grupit të Punës. Grupi i Punës u krijua më në fund në shkurt të vitit 2015. Projekti ka organizuar tre workshope (11-12 dhjetor 2014, 25-27 mars 2015 dhe 22 qershor 2015), me qëllim që të udhëzohet dhe të ndihmohet Grupi i Punës me hartimin e ndryshimeve të ligjit për LPP/LFT në përputhje me standardet e zbatueshme ndërkombëtare.

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Gjendja	Veprimet/Sfidat
			Sfidat Ngërçi politik 6-mujor pas zgjedhjeve të përgjithshme qershorit 2014 vonoi ngritjen zyrtare të Grupit të Punës. Kjo u shoqërua me bashkërendimin dhe bashkëpunimin e fragmentuar me palët përkatëse, gjë që vuri në rrezik zbatimin e plotë të këtij aktiviteti. Për ta zbutur këtë rrezik, projekti u desh të zgjatet pa kosto për 3 muaj të tjerë.
Veprimi 4.2 - Hartimi i ligjit të ri për LPP/LFT në koordinim dhe konsultim me të gjitha palët e interesuara	▪ Opinioni ligjor mbi projekt-ndryshimet në ligjin për LPP/LFT u përgatit dhe u diskutua me Grupin e Punës	Përfunduar	**Veprimet** Opinioni ligjor mbi projekt-ndryshimet e propozuara në ligjin për LPP/LFT u përgatit dhe u diskutua me Grupin e Punës Opinioni analizon përputhshmërinë e projektndryshimeve me standardet e zbatueshme ndërkombëtare dhe rekomandimet për adresimin e mangësive të identifikuara. Ai u plotësua me një version të rishikuar të projekt-ndryshimeve me komente shpjeguese ku është e nevojshme. Opinioni u diskutua me Grupin e Punës gjatë workshopit në qershor 2015, dhe u ndryshua më tej nën dritën e këtyre diskutimeve. Më pas, ai u përkthye në gjuhën shqipe dhe iu dorëzua NJIF-it për ta marrë në konsideratë në procesin e mëtejshëm të hartimit . **Sfidat** Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i fragmentuar; dorëzim i vonuar dhe jo i plotë i ndryshimeve të ligjit për LPP/LFT (maj 2015).

5 BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESUARA

5.1 Përfituesit homologë

Në tërësi, projekti PECK ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me aktorët e tij. Të dyja institucionet bashkërenduese për komponentët e vlerësimit të LKK dhe LPP/LFT- AKK dhe NjIF - demonstruan një rol proaktiv në procesin e vlerësimit, veçanërisht në fazën shumë intensive për nga burimet e kërkuara që përfshinte shpërndarjen e pyetësorëve të vlerësimit dhe projektraporteve në faza të ndryshme të hartimit të tyre, mbledhjen e përgjigjeve të pyetësorëve dhe kërkesave për informata shtesë, si dhe produkteve të tjera nga një gamë e gjerë e autoriteteve në Kosovë.

Shumica e autoriteteve në Kosovë bëri përpjekje për të marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit dhe për t'i siguruar projektit informatat e nevojshme. Thënë kjo, niveli i angazhimit të disa autoriteteve ka ndryshuar gjatë fazave të ndryshme të vlerësimit. Për shembull, përkundër afatit të zgjatur për dorëzimin e komenteve/informatave shtesë për raportet ndërmjetëse të LKK dhe LPP/LFT, për pyetësorët e LPP/LFT dhe projektraportet e vlerësimit për LKK dhe LPP/LFT të ciklit të 2^{të}, vetëm një numër i kufizuar i institucioneve dhanë informacione kthyese apo të dhëna të dobishme. Kjo ndodhi sidomos me pyetësorin e LPP/LFT të ciklit të 2^{të}, ku një numër pyetjesh nuk morën përgjigje ose morën përgjigje të pjesshme (projekti do të merrte informacion mbi ligjet, por jo domosdoshmërisht mbi zbatimin e tyre). Një shembull tjetër ka të bëjë me pjesëmarrjen në takimet dhe aktivitetet e organizuara nga Projekti, ku disa institucione kanë pasur një nivel më të ulët të pranisë/pjesëmarrjes se të tjerët, veçanërisht Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës Publike. Megjithatë, kjo ndryshoi në fund të procesit të vlerësimit dhe institucionet kontribuan me më shumë gatishmëri në diskutime dhe miratimin e raporteve përfundimtare të vlerësimit.

5.2 Palët e tjera të treta

Projekti ka bashkëpunuar në mënyrë efikase me EULEX-in që ka dhënë kontribut të vlefshëm në përgatitjen e raporteve të vlerësimit. Përfaqësuesit e EULEX-it kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet e Projektit të organizuara gjatë periudhës raportuese.

Takime të rregullta koordinuese janë mbajtur edhe me projekte të financuara nga BE-ja si "Përkrahje për institucionet e Kosovës për luftimin e krimeve financiare dhe ekonomike", "Mbështetje për Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara", si dhe me projektet e Binjakëzimit "Forcimi i kapaciteteve të hetimit penal kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit "dhe" Përmirësimi i përafrimit të ligjeve dhe koherencës së kornizës ligjore", me qëllim për të shkëmbyer informacion dhe për të shmangur mbivendosjet. Projekti ka zhvilluar gjithashtu konsultime me projektin e financuar nga UNDP "Mbështetje për përpjekjet anti-korrupsion në Kosovë" (SAEK).

Përfaqësuesit e UNMIK, UNDP, FMN dhe Bankës Botërore gjithashtu kanë qenë të ftuar rregullisht të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në aktivitetet e projektit, me nivele të ndryshme të pjesëmarrjes.

6 MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Projekti është vlerësuar dy herë në kuadër të Monitorimit të orientuar drejt rezultateve të BE-së (ROM) në tetor 2013 dhe qershor 2014, me qëllim për të siguruar informacion të jashtëm, objektiv dhe të paanshëm mbi kryerjen e projektit.

Siç parashihet me metodologji, ROM-i vlerësoi Projektin PECK për rëndësinë dhe cilësinë e projektimit, efikasitetin e zbatimit, perspektivat e ndikimit dhe qëndrueshmërinë e mundshme, dhe efektivitetin e tij deri në periudhën e vlerësimit. Raporti i parë ROM ishte shumë pozitiv dhe Projekti mori pesë A në të gjitha fushat e vlerësuara (vlerësimi jepet në një shkallë nga A deri D, ku A është nota më e lartë dhe D më e ulët). Vlerësimet ishin paksa më të ulëta në raportin e dytë ROM, ku projekti mori katër B dhe një C për efektivitetin e tij. Përshtypja e përgjithshme ishte se Projekti ngadalësoi ritmin e aktiviteteve dhe u perceptua të jetë më pak entuziast kur është fjala për zbatimin. Megjithatë, kjo mund t'i atribuohet mungesës së kuptimit të duhur të natyrës së veçantë dhe fushës së vërtetë të veprimit të aktiviteteve që ishin duke u ndërmarrë. Përveç kësaj, kjo është në kontrast me zbatimin e ciklit të 2[të] të vlerësimit që përfshiu një angazhim më aktiv të institucioneve përfituese. Ekipi i Projektit dha komente të detajuara për raportin ROM.

Thënë kjo, vëzhgimet kyçe të ROM ishin:
"[p]rojekti është duke prodhuar produkte të cilësisë së mirë dhe ato po kontribuojnë drejt arritjes së rezultateve të planifikuara. Rezultati që përqendrohet në vlerësimin kolegjial që duhet të kryhet nga institucionet e Kosovës po përballet megjithatë me një pengesë kohore (koha e mbetur nuk mjafton që të nxirret dobi e plotë nga zbatimi i cikleve të vlerësimit në nivel lokal dhe për të ndjekur në mënyrë adekuate rekomandimet nga raportet e vlerësimit). Pa një zgjatje të projektit, kjo ka të ngjarë të kufizojë ndikimin e projektit."

Rekomandimi lidhur me përmirësimin e raportimit u pranua dhe u zbatua në raportet e Projektit, përfshirë edhe këtë raport.

Projekti PECK është vlerësuar në kuadër të Vlerësimit Tematik të BE-së për mbështetjen IPA në luftën kundër korrupsionit. Performanca e PECK dhe produktet janë vlerësuar si shumë të mira. Më poshtë janë disa gjetje kryesore të vlerësimit:

"Projekti PECK / KiE ka qenë i dobishëm në vlerësimin e statusit të Kosovës në lidhje me standardet e GRECO-s dhe FATF-së në luftën kundër korrupsionit dhe trajtimin e tyre. Disa përmirësime janë të dukshme në kornizën ligjore kundër pastrimit të parave, të financimit të partive politike dhe deklarimit të pasurive, të cilat i atribuohen projekteve të BE-së.
[…]

PECK ka përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile në fazën e konsultimit të hartimit dhe paraqitjes së raporteve të vlerësimit, dhe sektori privat u përfshi gjithashtu gjatë vlerësimit në lidhje me kornizën përkatëse ligjore dhe procedurale kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave.
Dorëzimi i të gjitha produketeve të planifikuara ka qenë në bazë të planit [...]. Përfituesit janë të kënaqur që cilësitë e zbatimit dhe rezultatet janë shumë të mira.
[…]

Projekti PECK, i realizuar përmes marrëveshjes së drejtpërdrejtë me Këshillin e Evropës, dorëzoi produkte me cilësi shumë të mira dhe u konsiderua lart nga përfituesit. Projekti ka vlerësuar përputhshmërinë e masave të Kosovës për luftën kundër korrupsionit (LKK), kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (LPP/LFT) me Standardet e FATF-së 2012 dhe ka dhënë rekomandime të vlefshme për autoritetet e Kosovës me qëllim për të arritur reformat legjislative dhe organizative në përputhje me standardet ndërkombëtare. Raportet e Vlerësimit siguruan gjithashtu një bazë solide për vijimësinë e asistencës teknike ndërkombëtare në Kosovë në fushën e krimit ekonomik.

[…]

Edhe pse me një natyre vlerësuese, transferimi i njohurive është përfshirë në procesin e vlerësimit të PECK, i cili në të dy ciklet u koordinua me institucionet e Kosovës, si Agjencia kundër Korrupsionit dhe Njësia e Inteligjencës Financiare. Kjo u mundësoi institucioneve përkatëse të ballafaqohen me metodologjinë e vlerësimit të GRECO dhe MONEYVAL dhe ta përdorin atë praktikisht. Kjo ishte më e dukshme gjatë ciklit të dytë, ku është vërejtur angazhim më aktiv dhe intensiv nga institucionet e Kosovës".

7 PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

7.1 Përfundimet dhe mësimet e nxjerra

